



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:286131
Datë: 17.05.2024
Numri i dokumentit: 05699440

Pzd.nr.41/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Rasim Rasimi, kryetar i kolegjit, Afrim Shala dhe Mejreme Memaj, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini Simnica, si procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të dënuarit N. A., për shkak se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale “Krimet e luftës kundër popullsisë civile”, nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, aktualisht e penalizuar si “Krimet e luftës në shkelje të rëndë të Konventës së Gjenevës”, nga neni 144, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.2., 2.3. dhe 2.4. lidhur me paragrafin 1, nën-paragrafi 1.1. lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesës për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit të të dënuarit, të shqiptuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, PS.nr.55/2019, të datës 24.12.2020 dhe aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, APS.nr.11/2021 të datës 12.05.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 15.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit e të dënuarit N. A., të shqiptuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, PS.nr.55/2019, të datës 24.12.2020 dhe aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, APS.nr.11/2021 të datës 12.05.2021.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, me aktgjykimin PS.nr.55/2019, të datës 24.12.2020, e ka shpallur fajtor të dënuarit N. A., për shkak se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale “Krimet e luftës kundër popullsisë civile”, nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, aktualisht e penalizuar si “Krimet e luftës në shkelje të rëndë të Konventës së Gjenevës”, nga neni 144, paragrafi 2,

nën paragrafi 2.2., 2.3. dhe 2.4. lidhur me paragrafin 1, nën- paragrafi 1.1. lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) vjetëve, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 22.10.2019 e tutje.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin APS.nr.11/2021 të datës 12.05.2021, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e Prokurorisë Speciale të Kosovës dhe ankesën e mbrojtësit të të dënuarit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kërkesë për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit ka paraqitur i dënuari N. A., për shkak të rrethanave të cilat kanë ekzistuar në kohën e marrjes së aktgjykimit, por nuk janë paraqitur trupit gjykues, e të cilat po të ishin paraqitur do t'i kishte marrë parasysh gjatë caktimit të dënimit, me propozim që të aprovohet kërkesa dhe t'i zbutet dënimi.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KZJD.nr.41/24, të datës 03.05.2024, ka propozuar që kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit e të dënuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë, me shkresën KP.nr.57/2024, të datës 24.04.2024, ka propozuar që kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit e të dënuarit të refuzohet si e pabazuar dhe gjithashtu, edhe Prokuroria Speciale në Prishtinë, me shkresën PPS.nr.01/2016, të datës 29.02.2024, ka propozuar që kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit e të dënuarit të refuzohet, për shkak se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për zbutje të jashtëzakonshme.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës dhe kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, në pajtim me nenin 431 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) konstatoi se:

- kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit nuk është e bazuar.

Me dispozitën e nenit 429 të KPP-së, parashikohet se zbutja e dënimit të shqiptuar me aktgjykimin e formës së prerë, lejohet kur paraqiten rrethana që nuk kanë ekzistuar në kohën kur është marrë aktgjykimi ose gjykata nuk ka ditur për to, megjithëse kanë ekzistuar, e të cilat qartazi do të çonin në shqiptimin e një dënimi më të butë.

Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, vlerëson nëse rrethanat e reja që theksohen në kërkesë do të ndikojnë në një dënim më të butë, sikur të kishin ekzistuar dhe të ishin vlerësuar me rastin e shqiptimit të dënimit në procedurë të rregullt. Pra, kjo Gjykatë, pas paraqitjes së këtij mjete të jashtëzakonshëm, vlerëson në kuptim të dispozitës së nenit 429 të KPP-së nëse janë

plotësuar kushtet ligjore për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, duke i pasur parasysh rrethanat e reja të paraqitura në kërkesë.

Në kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, i dënuari ka theksuar se është me diabet, ka shtypje të lartë të gjakut, si dhe aritmi të zemrës, se me gjithë ndihmën të cilën ia ofron stafi mjekësor i institucionit, prapë nuk mund t'i ofrohet trajtimi adekuat i ushqimit dhe ai mjekësor, si dhe i njëjti ka nevojë që të kujdeset për nënën e tij e cila është e moshuar, ka më shumë se 90 vjet, është e sëmurë dhe e pafuqishme.

Kërkesës ia ka bashkangjitur Fletë lëshimin për N. A. nga Qendra Klinike në N., me ref.nr..., të datës 25.03.2019, Fletë lëshimin për N. A., nga Qendra Klinike në Prishtinë – G. të datës 26.12.2023, Raportin për N. A. nga Ministria e Drejtësisë – Departamenti shëndetësor i Burgjeve i datës 29.01.2024, Ekstraktin nga regjistri qendror i gjendjes civile për V. A., me Nr.ser. E ..., të datës 26.12.2023 dhe Deklaratën për bashkësinë familjare me Nr.ser. F ..., të datës 20.12.2023.

Është e rëndësishme që të theksohet se me rastin e caktimit të llojit dhe kohëzgjatjes së dënimit, gjykata e shkallës së parë, si rrethanë lehtësuese ka marrë parasysh faktin se i dënuari veprimet i ka ndërmarrë në kuadër të bashkëkryerjes, jeta e mëparshme e tij, ku gjykata nuk ka informacion se a ka kryer ndonjë vepër tjetër penale, në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i moshës relativisht të re 26 vjeçar, vepra penale është kryer njëzetënjë (21) vite më parë dhe gjatë kësaj periudhe i dënuari ka ndërtuar një jetë në Serbi dhe do të jetë larg familjes së tij.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se rrethanat të cilat i ka përmendur i dënuari nuk janë rrethana të asaj natyre, me peshë dhe rëndësi të veçantë të cilat në kuptim të dispozitës së nenit 429 të KPP-së e justifikojnë zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit.

Andaj, duke pasur parasysh se në kërkesën e të dënuarit nuk janë paraqitur rrethana të cilat qartazi do të ndikonin në zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se nuk ka kushte ligjore për aprovimin e kërkesës dhe në bazë të nenit 431, paragrafi 7 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pzd.nr.41/2024, më datë 15.05.2024

Bashkëpunëtorja profesionale,
Mirlinda Mejzini Simnica

Kryetar i kolegjit
Rasim Rasimi

Numri i lëndës: 2019:286131
Datë: 17.05.2024
Numri i dokumentit: 05699440